



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

K.Dh.Sh.II.nr.1012/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit KS Alpha Private Security Sh.p.k me nr. unik të biznesit 70236758, me seli në Prishtinë, rr. “Gjergj Balshaj” p.n, kundër debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, lidhur me pagesën e borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1052/22 të datës 26.05.2023, jashtë seancës gjyqësore, me datë 09.01.2024, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1052/22 i datës 26.05.2023, VËRTETOHET.

#### A R S Y E T I M

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1052/22 të datës 26.05.2023, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.967/21 i datës 23.08.2021 të lejuar nga Përmbartuesi privat Flamur S. Bogaj. II. Mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.967/21 i datës 23.08.2021 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S.Bogaj.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i debitorit, për shkak se nuk është konstatuar saktë gjendja faktike sepse kreditori vetëm se ka lëshuar faturën por në asnjë rrethanë nuk ka prezantuar si provë dokumentin me të cilin do të vërtetohej se debitori ka bërë-kërkuar kryerjen e shërbimit të faturuar. Debitori edhe në

prapësimin e paraqitur ka theksuar faktin se dokumentet e besueshme (në rastin konkret faturat) nuk i kanë përmbushur kriteret apo edhe elementet e detyrueshme ligjore pasi që të njëjtat nuk e kanë të paraparë afatin e pagesës, rrjedhimisht duke iu referuar afatit për kryerjen e obligimit financiar ndaj kreditorit. Faturimi i lëshuar nga ana e kreditorit po ashtu është bërë pas periudhës së kontraktimit në mes të debitorit dhe kreditorit, fakte këto të cilat kreditori i ka evituar qëllimisht në paraqitjen e propozimit për përmbarim. Kreditori me lëshimin e faturave në fjalë nuk ka përshkruar asnjë nga arsyet e faturimit apo përshkrimin mbi shërbimin e ofruar nga i njëjti por vetëm ka kërkuar që të bëhet pagesa nga ana e debitorit për shërbime në baza fiktive.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjyqtari individual i Dhomës së dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori: KS “Alpha Private Security” Sh.p.k me nr. unik të biznesit 70236758, me seli në Prishtinë, me dt.23.08.2021, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Komuna e Prishtinës-Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm, faturës nr.25/2021 të datës 18.08.2021, për shumën në vlerë prej 17,767.04 euro.

Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit, me Urdhrin P.nr.967/21 të dt.23.08.2021, ka lejuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm - fatura nr.25/2021 të datës 18.08.2021, i plotëson kushtet për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri, me datë 30.08.2021, debitori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur kundërshtim/prapësim, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-së me propozim për gjykatën që të pranohet kundërshtimi i debitorit Komuna e Prishtinës si i bazuar, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr. 967/21 i datës 23.08.2021 i lejuar nga zyra e përmbaruesit privat Flamur S. Bogaj, dhe të anulohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori në përgjigjen në prapësim deklaron se lejimi i përmbarimit është bërë konform nenit 29 pika 1.3 e LPP-së, fatura është lëshuar me datën 18.08.2021 për periudhën e kaluar dhe për punën e kryer prej datës 24.07.2021 deri 16.08.2021, madje ekziston edhe konstatimi për pagesën e borxhit sipas kësaj fature të lëshuar nga vet debitori me datën 18.08.2021, andaj kërkon nga gjykata që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbarimor P,nr.967/21 dt.23.08.2021 të lejuar nga përmbaruesi privat Flamur S.Bogaj në Prishtinë.

Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin të debitorit, dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1052/22 të datës 26.05.2023, ka Refuzuar prapësimin e debitorit duke vendosur më

decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se fatura nr.25/21 e datës 18.08.2021 në bazë të se cilës është lejuar urdhri për përmbaram dhe e cila faturë buron nga kontrata publike kornizë 616-21-2041-2-2-5/C581 e lidhur mes kreditorit dhe debitorit me datë 23.04.2021 për ofrimin e shërbimeve të sigurimit fizik i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, kjo pasi që në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkuara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe fatura është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt përmes nënshkrimit dhe vulosjes me vulën e protokollit të debitorit si institucion. Gjykata vlerësoj pretendimet tjera të debitorit të ngritura në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për ti mbështetur pretendimet e tilla e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaramit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit është vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Dhomave të shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së, apo procedurës përmbaramore, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbaramit dhe as pretendimet për gjendjen faktike sepse gjykata në procedurë përmbaramore e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit të besueshëm, vlerëson nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin përmbaramor dhe a ekzistojnë ndonjëra nga shkaqet për prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret, përmbarami i lejuar me anë të dokumentit të besueshëm - faturës në të cilën është mbështetur dhoma e shkallës së parë, e që vlerësohet si e drejt nga kjo Dhomë, mbështetet në dispozitat ligjore nga neni 29 paragrafi.1 pika 1.3 dhe paragrafi. 3 të LPP-së me të cilin theksohet se: *“1. Përmbarami me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3. faturat; ndërsa paragrafi. 3. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbaram po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.* Nga dispozita e lartcekur shihet qartë se dokumenti me të cilin kreditori e ka kërkuar përmbaramin është i besueshëm, në të është treguar kreditori dhe debitori, shuma e cila duhet të paguhet, e njëjta është pranuar dhe vulosur nga ana e debitorit si institucion.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se Dhomat e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e LPP-së, kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate sipas shkresave të lëndës konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.25/2021 të datës 18.08.2021, i cili në mbështetje të dispozitave nga nenin 29 paragrafi 1 pika 1.3 dhe par 3 të LPP-së, e ka cilësinë e dokumentit të besueshëm.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, nuk i vlerësoi si të bazuara pretendimet ankimore se kreditori në faturën përmbarimore nuk ka përshkruar asnjë nga arsyet e faturimit apo përshkrimin mbi shërbimin e ofruar nga i njëjti por vetëm ka kërkuar që të bëhet pagesa në baza fiktive. Kjo gjykatë vlerësoi se fatura përmbarimore nr.25/2021 e datës 18.08.2021 bashkangjitur propozimit për përmbarim të kreditorit, përveç tjerash përmban edhe informatat e përshkrimit të shërbimit si: sigurimi fizik i objekteve të kujdesit primar shëndetësor në Prishtinë me numër prokurimit 616-21-62-225.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Dytë

K..Dh.Sh.II.nr.1012/23 me datë 09.01.2024

Gjyqtari

Krenar Berisha